D E K R E T
Nr.1441, datë 4.4.1996

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7652, DATË 23.12.1992 "PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE" NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7828, DATË 1.6.1994

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.7652, datë 23.12.1992, ndryshuar me ligjin nr.7828, datë 1.6.1994 në nenin 7/a shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje:

"... banorë të zonave të cilët kanë qënë të detyruar të shpronësohen dhe të shpërngulen për të realizuar ndërtime me rëndësi publike e kombëtare sipas disponimit të Këshillit të Ministrave".

Neni 2

Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë dekret, shfuqizohen.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha